

VENDIM
Nr. 198, datë 1.10.2021

MBI MIRATIMIN E KËRKESËS SË SUBJEKTIT GEK TERNA GROUP, PËR APLIKIM NË TAP AG, PËR FAZËN JO TË DETYRUESHME NË TREG - TESTI I TAP AG, PËR KAPACITETIN DHE LIDHJEN E TERMOCENTRALIT ME CIKËL TË KOMBINUAR, ME FUQI 160–180 mw, NË ROSKOVEC, FIER

Në zbatim të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të neneve 13, 15, pika 1, germa “a”; 16, pika 24; 25; 17, pika 4; 19, pika 5 dhe nenit 108, të ligjit nr. 102/2015, “Për sektorin e gazit natyror”, të ndryshuar; të vendimit nr. 122, datë 11.5.2021, të Bordit të ERE-s, “Mbi miratimin e propozimit të projekteve TAP, SRG dhe DESFA, për procesin e rritjes së kapacitetit për vitin 2019”; të seksionit 4.7, pika 9, të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët të Rregullatorëve të Energjisë së Italisë, Greqisë dhe Shqipërisë, korrik 2013, si dhe opinionin 1/2013, të Sekretariatit të Komunitetit të Energjisë, datë 14 maj 2013, “Mbi përjashtimin e ndërlidhësit TAP AG nga kërkesa të caktuara, sipas direktivës 2009/73/EC, nga Autoriteti Rregullator i Energjisë në Shqipërisë”; të nenit 15, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 3.9.2016; Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e datës 1.10.2021, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 123/5 prot., datë 29.9.2021, të përgatitur nga Drejtoria e Gazit Natyror, mbi “Kërkesën e subjektit GEK Terna Group, për aplikim në TAP AG, për fazën jo të detyrueshme në treg – testi i TAP AG, për kapacitetin dhe lidhjen e termocentralit me cikël të kombinuar, me fuqi 160–180 mw, në Roskovec, Fier”,

konstatoi se:

- Me shkresën nr. 910, datë 1 shtator 2021, GEK Terna Group paraqiti tek Enti Rregullator i Energjisë në Shqipëri (ERE) “Kërkesën për aplikim nga GEK Terna Group, për fazën jo të detyrueshme në treg - testi i TAP AG, për kapacitetin dhe lidhjen e termocentralit me cikël të kombinuar, me fuqi 160–180 mw, në Roskovec, Fier”; në përputhje me nenin 4.7, pika 9, të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët të Rregullatorëve të Energjisë së Italisë, Greqisë dhe Shqipërisë dhe me direktivën 2003/55/EC e Parlamentit dhe Këshillit Evropian, datë 26 janar 2003, lidhur me rregullat e përbashkëta në tregun e brendshëm të gazit natyror;

- TAP AG, sipas neneve 4.1, pika 7 dhe 4.7, pika 2, 6 dhe 9, të Opinionit Përfundimtar të Përbashkët të Rregullatorëve të Energjisë së Italisë, Greqisë dhe Shqipërisë, është e detyruar të plotësojë kërkesat për kapacitetin detyrues/lidhës të cilat rezultojnë nga çdo testim tregu.

- Referuar njoftimit të fazës jodetyruese për testin e tregut TAP AG 2021, kërkesat nga palët e interesuara, për lidhjet/kapacitetet jodetyruese, duhet të paraqiten në TAP AG deri më datë 11 tetor 2021.

- Faza jodetyruese e testimit të tregut, për vitin 2021, nga Gazsjellësi Trans Adriatik, ka filluar në 12 korrik 2021. Testi i tregut duhet të kryhet në përputhje me udhëzimet e miratuara bashkërisht me autoritetet rregullatore italiane (ARERA), greke (RAE) dhe shqiptare (ERE).

- GEK Terna Group shprehet se është në fazën paraprake, jo të detyrueshme, të përcjelljes së njoftimit/kërkesës, për lidhjen dhe kapacitetin e gazit natyror pranë shoqërisë TAP AG dhe është në përputhje me parimet e përcaktuara në Opinionin Përfundimtar të Përbashkët, me udhëzimet e testit të tregut, si dhe me legjislacionin evropian dhe kombëtar për kapacitetin rritës të transmetimit të gazit.

- Duke qenë se aplikimi nga GEK Terna Group është në përputhje me parimet e përmendura në Opinionin Përfundimtar të Përbashkët, udhëzimet e testit të tregut, “Kodin e rrjetit për mekanizmat e alokimit të kapacitetit”, si dhe me legjislacionin evropian dhe kombëtar për kapacitetin rritës të transmetimit të gazit, ERE nuk ka kundërshtime për këtë kërkesë.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s,

VENDOSI:

1. Të miratojë “Kërkesën e subjektit GEK Terna Group, për aplikim në TAP AG, për fazën jo të detyrueshme në treg - testi i TAP AG, për kapacitetin dhe lidhjen e termocentralit me cikël të kombinuar, me fuqi 160–180 mw, në Roskovec, Fier”, të paraqitur nga GEK Terna Group.

2. Drejtoria e Gazit Natyror të njoftojë subjektin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim në ERE brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

NË MUNGESË DHE ME AUTORIZIM
KOMISIONERI
Adriatik Bego